



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.959/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen juridike-përmbartimore të kreditorit Kompania Regjionale Ujësjetllësi “Prishtina” Sh. A, me seli në Prishtinë, rr. “Hazir Shala”, nr.4, kundër debitorit “Unitex Station” SH.P.K., me seli në rr. “Migjeni” në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.468/21 të datës 26.03.2021 të Përmbartuesit Privat Valdrin Beka, jashtë seancës me datën 26.05.2023 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Unitex Station” SH.P.K., dhe Urdhri Përmbartimor P.nr.468/21 i datës 26.03.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Regjionale Ujësjetllësi “Prishtina” Sh. A, me seli në Prishtinë, ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.468/21 të datës 26.03.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të ekstraktit të verifikuar nga librat afarist të kontabilitetit me shifër 3036, duke e obliguar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri t’i paguaj kreditorit borxhin prej 4,429.34 €, si dhe shpenzimet e përmbartimit sipas tarifës së përmbartuesve privat në pajtim me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014 për Tarifat, Shpërblimet dhe Kompensimin e Shpenzimeve për Përmbartuesit Privat, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm, me ndalimin e mjeteve në para të cilat i ka debitori në xhirollogarinë e tij bankare, dhe bartjen e shumës përkatëse në xhirollogarinë bankare të kreditorit, ose me konfiskimin dhe shitjen publike të sendeve të luajtshme të debitorit dhe bartjen e atyre mjeteve në xhirollogarinë e kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka deklaruar se urdhri përmbartimor i lëshuar nga përmbartuesi privat është i pabazuar, ngase debitorit i mungon legjitimiteti pasiv për të qenë palë në procedurë, ngase debitori nuk ka seli në adresën të cilën kreditori ka ushtruar propozimin për përmbartim me të cilën është lejuar Urdhri Përmbartimor. Më tej ka shtuar se dokumenti i bashkangjitur nuk përbënë dokument të besueshëm dhe se propozimi nuk pasqyron periudhën kohore të saktë si dhe kërkesa është parashkruar konform dispozitave të nenit 360 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje LMD). I ka propozuar gjykatës që të merret një vendim pozitiv në favor të debitorit si dhe ka kërkuar shpenzimet e përpilimit të prapësimin.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ndër të tjera ka deklaruar se pretendimet e debitorit në lidhje me atë se nuk është me seli në Rr. “Migjeni”, në Prishtinë nuk qëndrojnë, ngase debitori ka bërë kërkesë tek kreditori ku ka kërkuar ndryshimin e emrit si dhe ka nënshkruar kontratë për shërbime të ujit, të cilat i ka nënshkruar drejtori i debitorit. Ka shtuar se ka parashkrim të kërkesës, ngase debitori me pagesat e realizuara brenda periudhës kohore nga viti 01.01.2013 e deri më 21.05.2021 vazhdimisht ka pohuar borxhin dhe se në kuptim të nenit 368 të LMD-së, kemi ndërprerje të parashkrimit dhe se në rastin konkret debitori faturohet si biznes andaj parashkrimi për biznese rregullohet në kuptim të dispozitave të nenit 355 të LMD-së. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit, dhe në rast të ankesës t’i caktojë debitorit shumën e garancionit deri në vlerën e borxhit si në propozim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm - Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist Nr. 3036, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa në par.2 të po këtij

neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen “*ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave*”, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “*Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.*”.

Në rastin konkret pavarësisht faktit se propozimi për përmbartim është lejuar sipas Ekstraktit nga librat e kontabilitetit - Kartela Financiare e Konsumatorit në kuadër të Kompanisë Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” Sh. A, gjykata gjen se dokumenti mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, nuk i plotëson kushtet që të konsiderohet dokument i besueshëm për shkak që nuk i përmban tiparet e një ekstrakti nga librat afarist, meqenëse në këtë dokument nuk janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, si dhe periudha kohore për të cilën kërkohet përmbushja e detyrimit nuk evidentohet saktësisht në ekstraktin nga librat afarist.

Nga ekstrakti afarist i bashkëngjitur sipas shifrës 3036, rezulton se borxhi në shumën prej 4,429.34 €, është kërkuar për periudhën kohore nga data 01.01.2013 deri me datën 24.03.2021, ndërsa në përmbajtjen e këtij ekstrakti, nuk është përfshirë fare periudha prej datës 01.01.2013 deri me datën 30.12.2013, me ç’ rast nuk dihet se për cilat shërbime dhe për cilën periudhë kohore është grumbulluar borxhi në fjalë.

Andaj pasi që gjykata vlerësoi se dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbartimor në rastin konkret, nuk i ka tiparet e dokumentit të besueshëm si dhe nuk ka tipare të përmbartueshmërisë, si rrjedhojë nuk i shqyrtoi fare pretendimet tjera të debitorit të paraqitura në prapësim dhe duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.959/22, datë 26.05.2023

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.